



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 279/Prot
112

Berat, më 22/04 / 2024

VENDIM


Nr. 4, datë 19.04.2024

**PËR VENDOSJEN E ESHTRAVE TË “DËSHMORIT TË ATDHEUT” PËLLUMB
HYSNI RRAPO, NË VARREZAT E DËSHMORËVE TË ATDHEUT TË QYTETIT TË
BERATIT**

Këshilli i Qarkut Berati mbledhur sot më datë 19.04.2024 në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 109/2018, datë 20.12.2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 151, datë 25.04.2002 “Për Statusin Dëshmor i Atdheut” i ndryshuar, Shoqatës Kombëtare e ushtarakëve në rezervë të Shqipërisë, Dega Berat për rivarrimin e mbetjeve mortore në varrezat e dëshmorëve të atdheut të qytetit të Beratit të dëshmorit të atdheut Pëllumb Hysni Rapo, shpallur dëshmor i atdheut me Vendim nr. 2506/2, datë 01.09.1999, ku kërkohet vendosja e eshtrave të tij në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut” të qytetit të Beratit, të cilat aktualisht gjenden në Bashkinë Dimal, protokolluar me tonën Nr. 1007 Prot, datë 23.11.2023 si dhe korrespondencës me Bashkinë Berat dhe Bashkinë Dimal ;

VENDOSI;

1. Të bëhet vendosja e eshtrave të “Dëshmorit të Atdheut” Pëllumb Hysni Rapo (1958 - 1981), i shpallur i tillë me Vendimin Nr. 483, datë 14.11.2011 të Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut” të qytetit të Beratit.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut Berat Sektori Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave dhe Sektori i Financës Zhvillimit Rajonal e Investimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.



Këshilltarë gjithsej: 18

Morën pjesë në votim: 12

Votuan Pro: 12